



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në mbështetje Ligjit nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM, nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”; dhe të Rregullores së Brendshme nr. 492, datë 30.07.2020 “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”, në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP-it, shpall thirrjen për bashkëpunëtorë që mund të angazhohen për hartimin e kuadrit rregullator që lidhen me funksionimin e brendshëm të institucionit dhe zbatimin e Planit të Integritetit, si dhe hartimin e raporteve përkatëse.

Bashkëpunëtorët duhet të përmbushin këto kërkese:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët: shkenca juridike, shkenca ekonomike, shkenca matematike/informatike, ose mësuesi.
2. Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në administratën publike ose në menaxhim arsimi.
3. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
  - Hartimin dhe shkrimin e rregulloreve, protokolleve, ose metodologjive lidhur me funksionimin e brendshëm të institucioneve shtetërore.
  - Bashkëpunime me ASCAP-in dhe institucione të tjera të administratës shtetërore, lidhur me funksionimin e brendshëm institucional.
  - Njohuri të mira mbi funksionimin e institucioneve shtetërore, me prioritet ato arsimore, lidhur me legjislacionin për etikën.
  - Njohuri të mira mbi funksionimin e institucioneve shtetërore, me prioritet ato arsimore, lidhur me legjislacionin për konfliktin e interesit.
  - Aftësi për hartimin e kuadrit rregullator, lidhur me administrimin e dokumentave financiare dhe ruajtjen e informacionit me karakter shtetëror.
  - Aftësi për hartimin e formateve standarde për praktika të thjeshta pune.
  - Aftësi për hartimin planeve dhe raporteve që lidhen me transparencën.
  - Njohuri të mira në analizën statistikore të të dhënave, duke përdorur programet kompjuterike, si dhe aftësi të mira digjitale.
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Të kenë njohuri në gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të dokumentit të identitetit dhe certifikatave të trajnimit apo kualifikimit, pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në adresën: *Rruga "Naim Frashëri"*, Nr.37, Tiranë, ose me e-mail [sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al) brenda datës 17.03.2025, ora 16.30.

***Faleminderit!***